



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Seanca plenare  
Nr. 02-51/12-07  
Prishtinë, më 27 prill 2007, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

**Kryesuesi** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 86 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 13 prillit 2007,
3. Koha për pyetje dhe për përgjigje,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikatet.

Në fillim të seancës Kuvendi, me kërkesë të kryesuesit të seancës, mbajti **një minutë heshtje** në shenjë përkujtimi dhe nderimi për personat e pagjetur, ngase 27 prillin e kishte shpallur Ditë e të Pagjeturve të Kosovës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës kishte kërkuar që pika e tretë – Koha për pyetje parlamentare dhe për përgjigje të Qeverisë të shtyhet për seancën e radhës me arsyetim se kabineti qeveritar ishte i zënë në takimet me Grupin Faktmbledhës të KS të OKB-së.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha** në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kërkoi që pika e katërt – Projektligji për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse të shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi i hodhi në votim kërkesën e Qeverisë së Kosovës dhe të deputetes Fatmire Mulhaxha.

**Kuvendi** me shumicë votash miratoi kërkesën e Qeverisë së Kosovës dhe të deputetës Fatmire Mulhaxha që pika e tretë dhe e katërt të shtyhen për seancën e radhës.

### **2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 13 prillit 2007**

Procesverbali i seancës plenare të 13 prillit 2007 u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikatet**

**Kryesuesi** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pulltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7,8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime-----2.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për kimikatet.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 10: 45 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

---

E hartoi

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**